



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM

Nr. 330, datë 26.07.2021

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Florin Demollari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: "Neni 76 i Kodit Penal".

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Arjeta Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 139 i Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}. etj.; Akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR